Kuvendi i Komunës Klinë

Komiteti për Politikë dhe Financa

01Nr 06-35506 **/26**

Klinë, dt: 10.11 **/26**

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e tetë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 09.10.2026, me fillim nga ora 09:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi, z. Enver Berisha, i cili përshëndeti nënkryetarin e Komunës, z. Fadil Gashi, drejtorin e Administratës, z. Binak Sylaj, drejtorin e Financave, z. Faruk Smajli, drejtorin e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës, z. Nikson Daka, si dhe të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e KPF-së;
3. Shqyrtimi i Raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2026 (ref. Drejtoria për Financa);
4. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave (ref. Ekzekutivi);
5. Shqyrtimi i kërkesave të pranuara në Komitetin për Politik dhe Financa gjatë periudhës gusht-shtator 2026;
6. Të Ndryshme.

Enver Berisha, kryesues, Mirë se keni ardhur në mbledhjen e VIII-të të Komitetit për Politikë dhe Financa, të datës 09.10.2026. Besoj se materialin e mbledhjes e keni pranuar me kohë. A ka dikush ndonjë propozim apo diçka për të shtuar lidhur me rendin e ditës?

Enver Berisha, kryesues, Meqenëse nuk keni asgjë për të shtuar lidhur me rendin e ditës, atëherë po e hedhim në votim.

Enver Berisha, kryesues, Kush është **PËR**?

Me 7 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Enver Berisha, kryesues: Lidhur me pikën e parë të rendit të ditës, „Arsyetimi i mungesave", u njoftuan të pranishmit se në këtë mbledhje janë prezentë të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e KPF-së.

Enver Berisha: A ka dikush diçka për të shtuar rreth procesverbalit të kaluar?

Enver Berisha, kryesues, Mbasi nuk keni asgjë për të shtuar rreth Procesverbali të mbledhjes se kaluar, atëherë po e hedhim ne votim.

Enver Berisha, kryesues: Kush është **PËR**?

Me 7 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA Procesverbali i mbledhjes se kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i Raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2026 (ref. Drejtoria për Financa).

Enver Berisha, kryesues, Fjalën e ka Drejtori i Financave z. Faruk Smajli, për Shqyrtimin e Raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2026.

Drejtori i Financave z. Faruk Smajli, Përshëndetje Kryesues, Nënkryetarë, Drejtor dhe të gjithë ju anëtarë të Komitetit për Politik dhe Financa. Ne vijim paraqesim raportin financiar për periudhën janar-shtator të vitit 2026. Buxheti i përgjithshëm i Komunës është 17,304,308.75 €, sa i përket realizimit të shpenzimeve ne ketë periudhë janar- shtator këto kane arritur ne

14,226,271.44 € ose 81.33% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2025 shpenzimet vërehen një rritje prej 13.19%.

Shpenzime për kategorinë e pagave dhe mëditjeve, kane arritur ne 7,928,077.65 € ose 82.87%, ne raport me periudhën e njëjtë është një rritje prej 18.15% ndikim ne këtë rritje ka qen ekzekutimi i pagës se 13.

Shpenzime ne mallra dhe shërbime, Ne këtë 6 mujor kane arritur 1,621,452.70 €, ose 84.84 % të vlerës se përgjithshëm ne këtë kategori, ne raport për periudhën e njëjtë është një rritje prej 26.43 %, ndikim ne këtë rritje kane pasur borxhet e vitit 2025, si dhe kontratat kolektive të Arsimit.

Shpenzimet Komunale, Ne këtë kategori janë shpenzuar 384,244.68 €, apo 78.42 % të vlerës se përgjithshme ne këtë kategori, ne raport me periudhën e njëjtë kemi një rritje të vogël prej 2.52 %,

Shpenzimet në subvencione dhe transfere, Janë shpenzuar prej 826,503.96 € apo 88.90% të vlerës se përgjithshme, këtu kemi pasur një rritje prej 57.99% , Ndikim në këtë rritje të shpenzimit ka pasur pagesat direket nga Thesari të dalura nga kontrata kolektive të arsimit.

Shpenzimet kapitale, Gjithsej janë shpenzuar 3,465,992.45 €, apo 75.44 % të vlerës se përgjithshme ne këtë kategori, ndërsa sa i parkete të hyrave vetanakë ne këtë 6 mujor kane arritur ne shifrën prej 1,547,895.26 qe përbehet 99.75% të planifikimit vjetor, të planifikuara kane qene 1,551,784 Euro, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak kemi një rritje prej 11.5% respektivisht 159,592 Euro me shumë krahasuar me 9 mujorin e vitit paraprak. Përkundër këtyre sfidave të vonimit të shtimit të buxhetit komuna ka arritur të mbaj një nivel të kënaqshëm të realizimit të buxhetit.

Enver Berisha, kryesues, Faleminderit drejtor, hapim debatin:

Enver Berisha, kryesues, Po urdhëro z. Valmir Bacaj e ka fjalën.

Valmir Bacaj, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, kemi pranuar raportin për 9 mujorin e komunës se Klinës për vitit 2026 ashtu siç tha edhe drejtori i financave z. Faruk Smajli vlen te përmendët të rriturat vetanakë për 159 mije, është lajm i mire për komunën e Klinës, pastaj edhe realizimin e buxhetit ne vlerë të 81% ne këtë 9 mujor. Tek arsyeshmërija e shpenzimeve ka arsyeshmëri të rritja e shpenzimeve përshkak të pagën se 13, por edhe përshkakë të vendimeve gjyqësore, kontributin tone ne do të dhjamë edhe ne seancën e ardhshme për këtë raport, ju faleminderit.

Enver Berisha, kryesues, Faleminderit z. Bacaj, a dëshiron ndonjë kush tjetër të merre fjalën?

Enver Berisha, kryesues, Po, urdhëro, z. Esat Raci e ka fjalën.

Esat Raci, Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, me beri përshtypje investimet kapitale ka ngecje 5.76% mos gaboj, perëndimin time kane mbetur edhe 3 muaj deri ne përfundim qe i kane parapare projektet kapitale qe ti kryeni me kohe, ju faleminderit.

Enver Berisha, kryesues, Faleminderit z. Raci.

Enver Berisha, kryesues, A dëshiron dikush tjetër të marrë fjalën rreth kësaj pike?

Enver Berisha, kryesues: Mbasi nuk e dëshiron askush tjetër fjalën, atëherë kush është për rekomandim të kësaj kjo pikë për seancën e radhës.
Atëherë po e hedhim në votim.

Me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të raportit të menaxhimit financiar për periudhën janar-shtator 2026, rekomandoi që i njëjti të kaloj për shqyrtim në Kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronave (ref. Ekzekutivi).

Enver Berisha, kryesues, Para se t'ia kaloj fjalën drejtorit të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, z. Nikson Daka, kërkoj një sqarim shtesë lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Nëse dokumentacioni ende nuk është i kompletuar, ju lutem që materiali i plotë të na përcillet për në seancën e Kuvendit, në mënyrë që të shmangim kthimin e lëndës nga ministria për plotësim, apo rekomandim, pasi kjo po na shkakton vonesa në punë si Kuvend. Prandaj, është e rëndësishme të sigurohemi që dokumentacioni të jetë i kompletuar para se të procedohet më tutje.

z. Nikson Daka, Drejtori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë: Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë. Për arritjen e qëllimit të ligjshëm publik dhe realizimin e projektit "Sheshi dhe Trotoari", si dhe rregullimin dhe zgjerimin e rrugës Malë Bashota, dhe duke u bazuar në Planin Zhvillimor Komunal e duke marrë parasysh interesin e përgjithshëm. Për këtë qëllim, Komuna e Klinës ka pranuar vlerësimin e pronave nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, lidhur me nevojën për realizimin e projektit të lartcekur, dhe kërkoj qe të përfshihet ne rendin ditës projekte propozimet përkëmbimetë e parcelave private me atë të komunës së Klinës, ne kuadër të kësaj procedure:

Në kuadër të kësaj procedure janë të përfshira tetë (8) parcela private, të cilat janë të nevojshme për realizimin e këtij projekti, përkatësisht:

1. Një (1) parcelë në lokacionin "Sheshi Mujë Krasniqi", rruga "Leonard Palucaj":
Pjesa e parcelës nr. 441-2 (ZK Klinë), me sipërfaqe 4 m², e regjistruar në emër të pronarit privat Arben Coli, këmbehet me pjesën e parcelës 443-4, ZK Klinë, me sip. 4 m², e cila evidentohet në emër të Komunës së Klinës;

2. Shtatë (7) parcela në rrugën "Malë Bashota":

Pjesa e parcelës nr. 1731-1, ZK Dresnik me sipërfaqe 493 m², e regjistruar në emër të Ymer Millaku, këmbehet me pjesën e parcelës 2246-0 ZK Dresnik, me sipërfaqe 230 m², e cila është e regjistruar si pronë shoqërore-rrugët;
Pjesët e parcelave 1933-2 (sip. 27 m²), 1933-3 (sip. 108 m²), 1737-0 (sip. 126 m²), 1379-0 (sip. 4 m²), 1378-0 (sip. 281 m²) dhe parcela 1369-1 (sip. 163 m²), të gjitha në ZK Dresnik, të regjistruara në emër të Safet Gashi dhe Shefkije Gashi (me nga 1/2 e pjesës), këmbehen me pronën 1912-1, ZK Dresnik, me sipërfaqe 322 m², e regjistruar si pronë shoqërore-rrugët.
Të gjitha propozimet për këmbim vijën si domosdoshmëri e projektit me qene se disa projekte kane ne shpronësim por konfiguracioni i parcelave nuk lejon të vazhdohet me shpronësim, sepse palëve ju shkaktohet dëme sepse nder të tjera ka të ndërtuar asete patundshmëri prandaj vjen ne shprehje këmbimi sepse sipërfaqet vlerësohen nga ministria e financave, dhe ne jemi ne pritje të ministrisë se financave, sepse me kane premtuar se ne seancën e tetorit ne do të kemi materialin, dhe i njëjti do të dorëzohet të zyra e kuvendit dhe tek ju. Për këto të fundit ende nuk kemi raport të vlerësimit të pronave, por që sipas premtimit të ministrisë deri në seancë do të përfundoi edhe raporti i vlerësimit dhe do ta sjellim për Kuvend, dhe ju ftoj qe ta votoni.

Enver Berisha, kryesues, Ju faleminderit drejtor.

Enver Berisha, kryesues, Hapim debatin për këtë lende qe është rekomanduar nga kryetari i Komunës të Klinës për këto parcela.

Enver Berisha, kryesues, A dëshiron ndonjë kush tjetër fjalën?

Enver Berisha, kryesues, Po, urdhëro z. Esat Raci e ka fjalën.

z. Esat Raci: Faleminderit kryesues, unë dua qe të beje vetëm një pyetje, drejtorit z. Nikson Daka, a është pajtueshmëria e të dy anshme e pronareve private?

z. Nikson Daka, Drejtori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, po pajtueshmëria është e të dy anshme.

Enver Berisha, kryesues, A dëshiron ndonjë kush tjetër fjalën?

Enver Berisha, kryesues, Po, urdhëro z. Valmir Bacaj e ka fjalën.

z. Valmir Bacaj, Faleminderit, kryesues. Ne jemi dëshmitarë se shumë projekte ngecin pikërisht për shkak të problemeve me shpronësimin e pronave. Sa i përket këtij propozimi, besoj se ai i ka kaluar edhe filtrat e nevojshëm të shqyrtimit. Bashkë me materialin e pranuar, kemi marrë edhe një shkresë nga Ministria e Financave, si dhe raportin e vlerësimit nga Ministria e Financave dhe nga Komuna.
Në shkresën e Ministrisë së Financave thuhet se, edhe pse raporti i vlerësimit është i vitit 2024, ai mbetet i vlefshëm, pasi projekti nuk ka arritur të përfundohet.
Prandaj, duke u bazuar në dokumentacionin që kemi pranuar dhe në materialet e tjera që do t'i marrim, ne do të jemi pro këtij këmbimi të pronave.

Enver Berisha, kryesues, Faleminderit z. Bacaj. A dëshiron ndonjë kush tjetër ta marrë fjalën?

Enver Berisha, kryesues, Meqenëse askush tjetër nuk kërkon fjalën, kush është për rekomandimin e kësaj pike të rendit të ditës për shqyrtim në seancën e radhës të Kuvendit Komunal?
Atëherë po e hedhim në votim.

Enver Berisha, kryesues, Kush është **PËR**?

Me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozimit të kryetarit të komunës për këmbimin e pronave, rekomandoi qe propozimi të kaloi për shqyrtim dhe miratim në kuvend me kusht që të sjellët raporti i vlerësimit edhe për 7 pronat e tjera në të kundërtën do të hiqet nga rendi i ditës.

Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të pranuara në Komitetin për Politik dhe Financa gjatë periudhës gusht-shtator 2026.

Enver Berisha kryesues, Në këtë mbledhje të Komitetit Politik dhe Financa kemi pranuar 3 kërkesa, dhe ato janë:

1.Kërkesë për sigurimin e një banese sociale.

2.Kërkesë për Ekzekutimin e vendimit NR. 11, 464-4703/13, date 01.08.2014, për lirimin e

rrugës publike nga uzurpuesi, Pjeter Prela.

3.Kërkesë për rishqyrtimin e kompensimit për pjesëmarrjen në KKSB.

Enver Berisha kryesues, E prezanton kërkesën e **–I-**rë

1.Kërkesë për sigurimin e një banese sociale:
Kërkesë e parashtruar nga znj. Sevdije Krasniqi, e lindur në Klinë, e cila thekson se jeton e vetme në një shtëpi private, për të cilën paguan qira mujore. Po ashtu, ajo thekson se është e divorcuar nga bashkëshorti i saj, i cili jeton në Gjermani së bashku me gjashtë fëmijët e tyre, dhe se ajo nuk ka mundësi të shkojë e t'u bashkohet atyre. Duke qenë se jeton në kushte të vështira, kërkon nga Komuna e Klinës që t'ia sigurojë një banesë sociale.

Enver Berisha kryesues, Kjo kërkesë duhet t'i përcillet Qendrës për Punë Sociale , në mënyrë që zyrtarët kompetentë të dalin në terren, ta konstatojnë gjendjen faktike dhe, në bazë të gjetjeve, të vlerësojnë se cilat veprime duhet të ndërmerren më tej.

Enver Berisha kryesues, A pajtoheni që këtë kërkesë t'ia rekomandojmë Asamblesë Komunale për shqyrtim, në mënyrë që të përcaktohet adresa e saktë institucionale dhe organi kompetent për trajtimin e mëtejshëm të saj?
Atëherë po e hedhim në votim.

Enver Berisha, kryesues, Kush është **PËR**?

Me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Sevdije Krasniqi, rekomandoi që kërkesa të përcillet në Qendrën për Punë Sociale për shqyrtim, si dhe të shqyrtohet mundësia e zgjidhjes së çështjes së banimit për të lartpërmendurën.

Enver Berisha kryesues, E prezanton kërkesën e **–II**-të

2. Kërkesë për ekzekutimin e vendimit Nr. 11, 464-4703/13, DATË 01.08.2014, për lirimin e rrugës publike nga uzurpuesi, Pjeter Prela:
Kërkesë e parashtruar nga z. Gjergj Prela, me banim në fshatin Stup, Komuna e Klinës, i cili thekson se, përmes kësaj kërkese, i drejtohet Asamblesë Komunale të Klinës me lutje që, në kuadër të kompetencave ligjore, të ndërmarrë veprimet e nevojshme për ekzekutimin e Vendimit nr. 11, 464-4703/13, të datës 01.08.2014, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronësi e Komunës së Klinës. Z. Gjergj Prela thekson se Pjetër Prela ka ndërtuar një objekt-garazh për vetura dhe traktorë në rrugën publike, në parcelën me numër 00265-0, ZK Stupë, duke e ngushtuar rrugën për 1.70 metra dhe duke e vështirësuar dukshëm qarkullimin e automjeteve, pasi me kamionë dhe me disa lloje të veturave nuk ka mundësi të qarkullohet. Kjo rrugë është e asfaltuar nga Komuna e Klinës. Me vendimin e lartcekur është përcaktuar që Pjetër Prela, me banim në fshatin Stup, Komuna e Klinës, ta lirojë rrugën të cilën e ka zënë me objekt-garazh, me sipërfaqe prej 160 m², që i përket njësisë kadastrale P-71011082-00265-0, Zona Kadastrale Stupë, Komuna e Klinës. Kjo pronë është pronë shoqërore, përkatësisht rrugë me destinim për infrastrukturë, e cila është uzurpuar në kundërshtim me dispozitat ligjore. Duke pasur parasysh se kanë kaluar shumë vite nga nxjerrja e këtij vendimi dhe se, sipas dijenisë së parashtruesit, ai ende nuk është ekzekutuar, kërkohet që Asambleja Komunale të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e tij, me qëllim të lirimit të rrugës publike dhe kthimit të saj në shfrytëzim sipas destinimit. Po ashtu, kërkohet që parashtruesi të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra dhe rezultatin e procedurës për ekzekutimin e këtij vendimi.

Enver Berisha kryesues, Fjalën për këtë kërkesë e ka z. Nikson Daka, Drejtori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.

z. Nikson Daka, Drejtori për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë: Po kryesues: unë edhe z. Faruk Smajli qe ne ate kohë ishte drejtor i inspektoratit, dua qe të theksoj se rasti është me Prokuri, ne

kemi shkresa të shpeshta se këta të janë familjare dhe qe të dytë kërkojnë qe ti lirojnë pronat e uzurpuara, por siç e citova edhe me larte se rasti është ne Prokuri.

z. Faruk Smajli Drejtori i Financave, Dëshiroj ta plotësoj edhe pak këtë çështje, pasi edhe unë jam marrë me të gjatë kohës kur kam qenë drejtor i Inspektoratit.
Përveç faktit që lënda është në Prokurori, ajo është gjithashtu edhe në proces të legalizimit, për të cilin është paraqitur edhe kërkesa përkatëse. Për këtë arsye, mendoj se duhet të pritet deri në përfundimin e procedurës së legalizimit dhe marrjen e një vendimi përfundimtar, para se të ndërmerret ndonjë veprim tjetër lidhur me këtë çështje.
Gjithashtu, me këtë lëndë është marrë edhe Hetuesia, pasi bëhet fjalë për një çështje që lidhet me mosmarrëveshje familjare. Prandaj, duke pasur parasysh se lënda është në procedura të ndryshme, konsideroj se për momentin duhet të presim sqarimet dhe vendimet përkatëse nga organet kompetente, pa ndërmarrë veprime të tjera deri në përfundimin e procedurës së legalizimit.

Enver Berisha kryesues, Faleminderit, z. Drejtor, për sqarimet shtesë. Mendoj se kjo pikë e rendit të ditës duhet të largohet nga shqyrtimi për momentin, pasi lënda është në Prokurori dhe njëkohësisht në proces të legalizimit. Për këtë arsye, konsideroj se është e arsyeshme të pritet deri në marrjen e një mendimi dhe sqarimi përkatës, në mënyrë që çështja të trajtohet më tej mbi baza të qarta.

Enver Berisha kryesues, Fjalën e ka z. Fadil Gashi nënkryetar i Komunës

z. Fadil Gashi, Nënkryetari i Komunës: Faleminderit, z. Kryesues. Përshëndetje për të gjithë! Është mirë që KPF-ja të japë një rekomandim lidhur me këtë çështje, pasi kërkesa i është drejtuar pikërisht këtij Komiteti. Duke qenë se, siç kanë deklaruar edhe drejtorët, lënda është në Prokurori, konsideroj se është e arsyeshme që KPF-ja t'i kthejë një përgjigje zyrtare parashtruesit të kërkesës, duke e njoftuar për qëndrimin e Komitetit. Kjo për faktin se KPF-ja, në këtë rast, është vetëm duke e shqyrtuar kërkesën.

Enver Berisha kryesues, A pajtoheni që Zyra e Kuvendit t'i kthejë një përgjigje lidhur me këtë çështje, duke u bazuar në qëndrimin e Komitetit, i cili është plotësisht legjitim, pasi lënda është ende në procedurë shqyrtimi nga të dyja palët, deri në marrjen e një sqarimi të ri? Gjithashtu, a pajtoheni që, deri në sqarimin e plotë të çështjes, Kuvendi Komunal të mos marrë vendim në Asamblenë Komunale?
Atëherë po e hedhim në votim.

Enver Berisha, kryesues, Kush është **PËR**?

Me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga z. Gjergj Prela, si dhe pas informatave të dhëna

nga ish-drejtori i Inspektoratit, z. Faruk Smajli, i cili theksoi se lidhur me këtë çështje ka qenë i informuar disa herë, por se lënda është duke u shqyrtuar në gjykatë dhe se, për këtë arsye, nuk kanë mundur të ndërmerren masa pa një vendim gjyqësor, KPF, rekomandoi që Sekretaria e Kuvendit t'i dërgojë një shkresë parashtruesit të kërkesës, duke e njoftuar se kërkesa e tij nuk do të procedohet për shqyrtim në drejtorinë përkatëse, përderisa çështja është në shqyrtim gjyqësor dhe nuk ka një vendim përfundimtar nga gjykata.

Enver Berisha kryesues, E prezanton kërkesën e **–III**-të.

3.Kërkesë për rishqyrtimin e kompensimit për pjesëmarrjen në KKSB.
Kërkesë e parashtruar nga znj. Diana Kerrellaj, e cila thekson: në lidhje me përgjigjen e Zyrës Ligjore, të cilën e kam pranuar përmes postës elektronike, kërkoj që të rishqyrtohet çështja e kompensimit tim për pjesëmarrjen në mbledhjet e KKSB-së. Unë jam anëtare e Komitetit për Komunitete, ndërsa në KKSB jam emëruar veçmas si përfaqësuese e komunitetit egjiptian, në bazë të nenit 4 të UA Nr. 27/2012 MPB–03/2012 MAPL. Pra, bëhet fjalë për dy mandate të ndryshme dhe me baza të ndryshme ligjore. Neni 14, paragrafi 3, i UA (MPL) Nr. 05/2020, i cili përcakton kufizimin për anëtarët e "komiteteve të tjera", u referohet komiteteve të themeluara për fusha të ndryshme të përgjegjësive komunale. Ndërsa KKSB-ja është trup i veçantë, i rregulluar me akt të veçantë. Për këtë arsye, konsideroj se kufizimi i përcaktuar për "komitetet e tjera" nuk mund të interpretohet automatikisht si ndalesë për anëtarësimin në KKSB. Po ashtu, neni 18 i UA Nr. 27/2012 përcakton kompensimin e anëtarëve të KKSB-së për pjesëmarrjen në mbledhje. Duke qenë se jam emëruar në mënyrë të rregullt si përfaqësuese e komunitetit në KKSB dhe kam marrë pjesë në mbledhjet e tij, kërkoj që të rishqyrtohet çështja e mos kompensimit tim. Nëse ekziston ndonjë dispozitë konkrete që e ndalon këtë anëtarësim të dyfishtë ose që e përjashton kompensimin tim për pjesëmarrjen në KKSB, ju lutem të më citohet konkretisht ligjor mbi të cilin mbështetet ky qëndrim. Gjithashtu, theksoj se me përgjigjen e Zyrës Ligjore jam njoftuar me vonesë, për të cilën edhe zyrtari që ma ka përcjellë përgjigjen ka kërkuar ndjesë.

Enver Berisha, kryesues, Ne këtë kërkesë ia adresojmë Drejtorisë për Financa, me qëllim të rishqyrtimit të kompensimit për pjesëmarrje në KKSB. Kërkojmë që Drejtoria ta shqyrtojë çështjen dhe të vlerësojë mundësitë ligjore dhe financiare për veprimet e mëtejshme.
Atëherë po e hedhim në votim.

Enver Berisha, kryesues, Kush është **PËR**?

Me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar nga znj. Diana Kerellaj, lidhur me rishqyrtimin e çështjes së kompensimit për pjesëmarrjen në mbledhjet e KKSB-së, rekomandoi që kërkesa t'i përcillet Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, për shqyrtim dhe vlerësim në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të saj. Gjithashtu, rekomandoi që drejtoria përkatëse, pas shqyrtimit të bazës ligjore dhe akteve normative në fuqi, të vlerësojë mundësinë e realizimit të kompensimit të kërkuar, nëse një gjë e tillë lejohet dhe parashihet me legjislacionin përkatës, përfshirë dispozitat e Ligjit për Pagat në Sektorin Publik dhe aktet nënligjore përkatëse, duke marrë parasysh natyrën e emërimit, bazën ligjore të pjesëmarrjes dhe kushtet që duhet të plotësohen për realizimin e pagesës.

Pika 6. Të Ndryshme.

Enver Berisha, kryesues, Nëse nuk ka çështje të tjera për diskutim, dëshiroj t'i falënderoj nënkryetarin e Komunës, z. Fadil Gashi, drejtorin e Administratës, z. Binak Sylaj, drejtorin e Financave, z. Faruk Smajli, drejtorin e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronës, z. Nikson Daka, si dhe të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj në diskutim.
Ju uroj punë të mbarë dhe shihemi në takimin e ardhshëm!

Procesmbajtësi,
Vedat Veselaj

KRYESUESI,
Enver Berisha